



## **DEKLARATË PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE ARBËRESHE E MINISTRES OGERTA MANASTIRLIU**

Të mbledhur sot, më 22 nëntor 2023, në Tiranë, në Ditën e Arbëreshëve-Samiti III i Diasporës, nën kujdesin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, përfaqësues të rajoneve italiane ku shtrihet komuniteti arbëresh: Puglia, Calabria, Basilicata, Abruzzo, Sicila, Molise dhe Campania, përfaqësues të komunave arbëreshe në të gjithë territorin italian, akademikë, studiues, publicistë, gazetarë, artistë dhe shkrimtarë, aktorë publikë dhe privatë, sipërmarrës dhe shumë qytetarë italianë arbëreshë, diskutuam dhe celebruam Ditën Arbëreshe, këtë thesar të paçmuar të popujve dhe vendeve tona, me dëshirën dhe synimin për t'u angazhuar më fort dhe për të gjetur rrugë të reja që do të duhet të përshkojmë, që kjo pasuri të trashëgohet, ruhet dhe zhvillohet me dashuri dhe përkushtim për brezat që do vijnë, dhe i drejtohem: Presidentit të Republikës italiane, Sh.T.Z. Sergio Mattarella, Presidentit të Senatit të Republikës Italiane, Senator Ignazio La Russa, Presidentit të Dhomës së Deputetëve të Republikës Italiane, të Nderuarit Lorenzo Fontana, Presidentit të Këshillit të Ministrave të Republikës Italiane, Sh.S.Znj. Giorgia Meloni. Miqësia dhe bashkëpunimi i ngushtë mes Shqipërisë dhe Italisë rrjedh nga një marrëdhënie historike mes popujve tanë, ku një vend të pazëvendësueshëm zënë Arbëreshët e Italisë. Ky shkëmbim i vazhdueshëm në shekuj mes kulturave dhe qytetërimeve shqiptare dhe italiane është mbështetur dhe frymëzuar gjithmonë nga drita e shejzave arbërore, e cila, edhe në kohët më të errta për kombin shqiptar, rrezatoi duke ngjallur shpresë e dashuri për mëmëdheun. Shqiptarë për nga origjina dhe italianë prej më shumë se 500 vjetësh, “gjaku ynë i shprishun” ruajti me krenari gjuhën e të parëve, traditat arbërore, figurën e Gjergj Kastrioti Skënderbeut dhe ritet fetare, duke dhënë, në të njëjtën kohë – me kurajo dhe idealizëm – një kontribut të rëndësishëm në lindjen dhe bashkimin e Italisë, dhe po aq në Rilindjen dhe Pavarësinë e Shqipërisë. Falë kujdesit dhe vëmëndjes së shtetit italian, Arbërishtja renditet mes gjuhëve të mbrojtura nga Kushtetuta. Në vlerësuam Ligjin 482/1999 për pakicat gjuhësore në Itali dhe çështjet për zbatimin e tij në rastin e gjuhës arbëreshe. Përshëndesim dhënien e hapësirës në RAI, të transmetimit të emisioneve radiofonike dhe televizive në gjuhën arbëreshe, dhe e vlerësojmë hap tjetër domethënës në mbrojtje dhe promovim të kulturës arbëreshe. Me synim konsolidimin e lidhjeve me botën arbëreshe, diskutuam mbi angazhimin e Qeverisë shqiptare për hartimin e një marrëveshjeje të posaçme me Qeverinë Italiane dhe rajonet italiane ku jeton minoranca gjuhësore arbëreshe, në zbatimin e mëtejshëm të Ligjit për pakicat gjuhësore, për të mbështetur mësimin e gjuhës arbëreshe dhe ruajtjen trashëgimit kulturor, për t'i dhënë rrugë formimit të mësuesve të gjuhës arbëreshe, me synimin që ajo të shndërrohet në gjuhë kurrikulare në shkollat dhe për promovimin e kulturës arbëreshe në çdo familje, përfshirë ato të komunitetit më të ri të shqiptarëve. Bashkëpunimi akademik dhe universitar duhet të shkojë përpara për të forcuar katedrat e gjuhës dhe letërsisë shqipe në të gjitha universitetet, laboratorë të mirëfilltë të shkencës albanologjike, dhe për çeljen e qendrave të tjera. Sistemi ynë arsimor duhet të kontribuojë për të mundësuar krijimin e një shkolle për të mbajtur gjallë gjuhën dhe kulturën tonë të përbashkët.

Bashkëpunimi mes aktorëve të shoqërisë civile është një vektor tjetër që synohet të orientohet drejt forcimit të lidhjeve mes Arbërisë italiane dhe Shqipërisë dhe hapësirës shqipfolëse në Ballkan. Shqipëria dhe arbëreshët do të angazhohen për të gjetur rrugë dhe instrumente të reja që nxisin jo vetëm transmetimin ndër breza të gjuhës, artit dhe kulturës arbëreshe, por edhe për të vendosur dhe konsoliduar lidhjen mes arbëreshëve dhe komunitetit më të ri të shqiptarëve të Italisë.

## **DICHIARAZIONE PER LA TUTELA DEL PATRIMONIO CULTURALE ARBËRESH DA PARTE DELLA MINISTRA ALBANESE DELLA ISTRUZIONE, OGERTA MANASTIRLIU**

Si sono riuniti oggi, 22 novembre 2023, a Tirana, nella Giornata degli Arbëreshë – III Summit della Diaspora, sotto gli auspici del Primo Ministro della Repubblica d’Albania, Edi Rama, i rappresentanti delle regioni italiane dove è ubicata la comunità Arbëreshe: Puglia, Calabria, Basilicata, Abruzzo, Sicilia, Molise e Campania, rappresentanti dei comuni arbëreshë di tutto il territorio italiano, accademici, ricercatori, pubblicisti, giornalisti, artisti e scrittori, soggetti pubblici e privati, imprenditori e tanti cittadini arbereshë italiani, hanno discusso e festeggiato l’Arbëresh Day, questo tesoro inestimabile dei nostri popoli e paesi, con il desiderio e l’intenzione di impegnarci con più forza e di trovare nuove strade che dovremo percorrere, affinché questa ricchezza venga tramandata, preservata e sviluppata con amore e dedizione alle generazioni a venire, e ci rivolgiamo al: Presidente della Repubblica Italiana, S.E. Sergio Mattarella, al Presidente del Senato della Repubblica Italiana, il senatore Ignazio La Russa, al Presidente della Camera dei Deputati della Repubblica Italiana, l’onorevole Lorenzo Fontana, al Presidente del Consiglio dei Ministri della Repubblica Italiana, S.E. Giorgia Meloni. L’amicizia e la stretta collaborazione tra Albania e Italia deriva da un rapporto storico tra i nostri popoli, dove gli Arbëreshë d’Italia occupano un posto insostituibile. Questo scambio continuo nel corso dei secoli tra le culture e le civiltà albanesi e italiane è sempre stato sostenuto e ispirato dalla luce delle Plejadi del mondo arbëror, che, anche nei momenti più bui per la nazione albanese, irradiava evocando speranza e amore per la madrepatria. Albanesi di origine e italiani da più di 500 anni, il « Gjaku Ynë i Shprishur [« il nostro Sangue Sparso] ha conservato con orgoglio la lingua degli antenati, le tradizioni arbëreshe, la figura di Giorgio Castriota Scanderbeg e i riti religiosi, donando, allo stesso tempo – con coraggio e idealismo – un importante contributo alla nascita e all’unificazione dell’Italia, e altrettanto al Rinascimento e all’Indipendenza dell’Albania. Grazie alla cura e all’attenzione dello Stato italiano, l’Arbërishtja è annoverata tra le lingue tutelate dalla Costituzione.

Abbiamo valutato l’impatto avuto dalla Legge 482/1999 sulle minoranze linguistiche in Italia e le problematiche della sua attuazione nel caso della lingua arbëreshe. Accogliamo con favore la concessione di spazi da parte della RAI per la trasmissione di programmi radiofonici e televisivi in lingua arbëreshe e la apprezziamo come un altro passo significativo per la tutela e la promozione della cultura arbëreshe.

Con l’obiettivo di consolidare i legami con il mondo Italo-albanese, si è discusso dell’impegno del Governo albanese di stipulare un’apposita convenzione con il Governo italiano e le Regioni italiane dove vive la minoranza linguistica arbërore, come ulteriore passo nell’attuazione della Legge sulle minoranze linguistiche, per sostenere l’apprendimento della lingua arbëreshe e preservare il patrimonio culturale, per dare il via alla formazione di docenti di lingua arbëreshe, con l’obiettivo che diventi lingua curriculare nelle scuole e per la promozione della cultura arbëreshe in ogni famiglia, comprese quelle facenti parte della più recente comunità albanese emigrata in Italia.

La collaborazione accademica e universitaria deve andare avanti per rafforzare in tutte le Università le cattedre di Lingua e letteratura albanese, i Laboratori di Albanologia e per l'apertura di altri Centri.

Il nostro sistema di istruzione deve contribuire a rendere possibile la creazione di una Scuola per tenere viva la nostra lingua e la nostra cultura comuni.

La collaborazione tra gli attori della società civile è un altro vettore che punta al rafforzamento dei legami tra l'Arbëria italiana, l'Albania e lo spazio albanofono nei Balcani.

L'Albania e gli Arbëreshë si impegneranno a trovare nuove vie e nuovi strumenti capaci di stimolare non solo la trasmissione alle nuove generazioni della lingua, dell'arte e della cultura arbëreshe, ma anche per stabilire e consolidare il legame tra gli arbëreshë e la più recente comunità albanese emigrata in Italia.

Si punta al coordinamento dell'azione tra le Accademie delle Scienze dei Paesi dell'area balcanica per sviluppare un programma comune, così come ad una interazione tra le Camere di Commercio e le Associazioni degli industriali con quelle del territorio arbëresh, ma anche al turismo delle radici, al turismo culturale, a quello scientifico, ecc.

Consideriamo la collaborazione sin qui attivata tra le istituzioni e gli ambiti accademici per la registrazione della proposta « MOTI I MADH » (Il Tempo Grande) nella lista delle buone pratiche dell'UNESCO come il primo passo di questo impegno che si tradurrà in una apposita convenzione e proseguirà con ulteriori accordi di cooperazione in tutti i settori di interesse per entrambe le parti.